

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, përmes gjyqtares së vetme gjykuese Snezhana Mihajllloviq, me sekretaren juridike Suzana Kovaçeviq, në lëndën penale kundër të pandehurit Sh.R. nga Gjilani, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378.paragr.6 lidhur me paragr.1 KPRK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.1472/17 e datës 31.08.2017, pas mbajtjes së seancës fillestare më dt. 26.04.2018, në prezencë të palëve publikisht shpalli

A K T G J Y K I M

I pandehuri **Sh.R.** nga babai I. dhe nëna D.-F., i lindur më dt. ... në ..., ku edhe jeton, rr. “ ... ” nr. ..., i arsimuar, ka të kryer fakultetin e informatikës, i pamartuar, i punësuar në agjenci turistike, i gjendjes së mesme ekonomike, deri më tani i pagjykuar, nuk zhvillohet procedurë për vepër tjetër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse më dt. 03 gusht 2017 rreth orës 02:50 minuta në rr. “ ... ” i pandehuri Sh.R. ka rrezikuar trafikun publik duke e vë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre, në atë mënyrë që duke e drejtuar automjetin e markës “BMW 730” me targa të regj. ... nga pakujdesia dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 53 dhe 54.1 pika 1.2 Ligji mbi Rregullat e Trafikut Rrugor, e për shkak të mos përshtatjes së shpejtësisë së lëvizjes dhe mos mbajtjes së distancës së nevojshme nga mjeti përpara, që të jetë në gjendje ta ndalë mjetin para çdo pengese që mund të paraqitet në rrugë, me pjesën e përparme të automjetit të tij e godet në pjesën e pasme motoçikletën e markës “MPB XC 125” me tab. të regj. ... të cilën e drejtonte Xh.M. dhe si pasojë e kësaj, nga lëshimet e lartpërmendura të pandehurit, përveç dëmeve materiale, lëndime të lehta trupore pëson i dëmtuari Xh.M., i cili për shkak të natyrës së lëndimeve kërkon ndihmë mjekësore në Emergjencën e Spitalit Regjional në Gjilan.

- me çka ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378.paragr. 6 lidhur me paragr. 1 të KPRK.

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 4,7, 17, 40,41,42,46,73 dhe 74 KPRK si dhe nenit 248 dhe 365 KPPK

E G J Y K O N

I. ME DËNM GJOBE në shumë prej 300 (treqind) € të cilin dënim i pandehuri është i obliguar ta pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën i njëjti ka për t'u zëvendësuar me dënim burgu, ashtu që për çdo 20 € të dënimit me gjobë do të llogaritet një ditë burgu.

II. I dëmtuari Xh.M. nga ..., rr. “ ... ” nr. ..., për realizimin e kërkesës pronësoro- juridike është udhëzuar në kontestin civil.

III. I pandehuri obligohet që në bazë të nenit 39 paragr.3 pika 1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimet, në emër të taksës të paguaj shumë prej 30 €.

IV. I pandehuri obligohet që në emër të paushallit të paguaj shumë prej 25 € si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan ka ngritë aktakuzë kundër të pandehurit Sh.R. nga Gjilani, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378.paragr.6 lidhur me paragr.1 KPRK, duke i propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe ta ndëshkoj sipas ligjit.

Gjatë seancës fillestare të mbajtur më dt. 26.04.2018, në të cilën është lexuar aktakuza e prokurorit të shtetit PP.II.nr. 1472/2017 e dt. 31.08.2017, dhe pas leximit të aktakuzës, i pandehuri Sh.R. deklaroi se e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale e cila i vihet në barrë, duke shtuar se e pranon fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale dhe i ka premtuar gjykatës se nuk do të kryej vepra të tilla apo çfarëdo vepre tjetër penale, do të ketë kujdes të shtuar gjatë vozitjes, i vjen keq për aksidentin që ka ndodhur, andaj, lutë gjykatën që ta ndëshkoj më butë.

Në seancën e parë fillestare, gjykatësja e vetme gjykuese mori Aktvendim me të cilin aprovoi pranimin e fajësisë, pasi që ka konstatuar se për këtë gjë janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore. Gjykatësja e vetme gjykuese ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë; pranimi është bërë me vullnetin e tij, pranimi i fajësisë përmban të gjitha faktet të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë të metë ligjore apo gabime faktike.

Konform kësaj, gjyqtarja e vetme vërtetoi gjendjen faktike:

- se i pandehuri Sh.R. ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378.paragr.6 lidhur me paragr. 1 KPRK.

Në nenin 378 thuhet “Kushdo që shkel ligjin mbi trafikun publik apo transportin rrugor dhe rrezikon jetën e njerëzve apo pasurinë dhe me këtë i

shkakton dikujt lëndim të lehtë trupor, do të ndëshkohet me dënim gjobe ose dënim burgu në kohëzgjatje deri në tri vite”.

Sikur që në veprimet e të pandehurit janë të përmbajtura të gjitha elementet e veprës së lartpërmendur penale, gjykata të pandehurin e shpalli faktor dhe e ndëshkoi sipas ligjit.

Në bazë të nenit 73 dhe 74 KPRK me rastin e shqiptimit të dënimit kundër të pandehurit, gjyqtarja e vetme gjykuese mori parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që si rrethana lehtësuese për të pandehurin gjykata i mori parasysh se deri më tani nuk ka qenë i gjykuar se është penduar për kryerjen e veprës penale duke i premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej kurrfarë vepre penale. Rrethana rënduese nuk ka pasur.

Sipas bindjes së kësaj gjykate shqiptimi i dënimit me gjobë ndaj të pandehurit i është i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit.

Gjykatësja e vetme gjykuese konstatoi se me këtë lloj të dënimit do të arrihet qëllimi i ndëshkimit nga neni 41 KPRK që i pandehuri në të ardhmen të mos kryej vepra tjera penale, t'i parandaloj personat tjerë në kryerjen e veprave penale dhe të paraqes gjykimin shoqëror për veprën penale, të rris moralin dhe fuqizoj obligimin për të respektuar ligjin.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 KPRK.

Nga të cekurat e mësipërme është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.915/2017 më dt. 26.04.2018**

**Sekretarja juridike,
Suzana Kovaçeviq**

**Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Snezhana Mihajllloviq**

UDHËZIMI JURIDIK: *Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa në dy kopje dorëzohet përmes kësaj gjykate.*

**Përktheu –
Naile Keçmezi**

